



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:275112

Datë: 07.10.2024

Numri i dokumentit: 06263963

**C.nr.4654/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari Gëzim Shehu, me bashkëpunëtorin profesional A.K. duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve P.Sh., M.V., A.L., S.A., R.V. të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. V.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt kontesti kompensimin e inflacionit në pagë, vlera e kontestit 1,783.55 euro, jashtë seance, me datë 07.10.2024, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve P.Sh., M.V., A.L., S.A., R.V. **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve t'ia kompensoj në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

**-Paditëses P.Sh.** për periudhën kohore prej datës 01.05.2022, e deri më datën 21.11.2022, t'ia kompensoj shumën prej **356.71 euro**.

**Paditëses M.V.** për periudhën kohore prej datës 01.05.2022, e deri më datën 21.11.2022, t'ia kompensoj shumën prej **356.71 euro**.

**Paditësit A.L.** për periudhën kohore prej datës 01.05.2022, e deri më datën 21.11.2022, t'ia kompensoj shumën prej **356.71 euro**.

**Paditësit S.A.** për periudhën kohore prej datës 01.05.2022, e deri më datën 21.11.2022, t'ia kompensoj shumën prej **356.71 euro**.

**Paditësin R.V.** për periudhën kohore prej datës 01.05.2022, e deri më datën 21.11.2022, t'ia kompensoj shumën prej **356.71 euro**.

në shumën e përgjithshme prej **1,783.55 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 11.12.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**II. DETYROHET** e paditura, që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **343.00 euro**, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

Paditësit P.Sh., M.V., A.L., S.A., R.V. përmes të autorizuarit të tyre V.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 11.12.2023, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtorisë Komunale të Arsimit, duke theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune në Gjimnazin "Remzi Ademaj" në Prizren dhe se paditësve nuk i është bërë kompensimi në pagë i pagesës së përqindjes së inflacionit sipas shkallës së inflacionit për vitin 2022. Ndërsa së fundmi me parashtrësën e datës 30.07.2024, i autorizuari i paditësve e ka precizuar kërkesëpadinë, duke kërkuar nga gjykata që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësve dhe të detyrohet e paditura që paditësve të ia bëjë kompensimin e pagës sipas shkallës së inflacionit dhe atë për vitin 2020 për periudhën 01 maj 2022 - 21 nëntor 2022, duke theksuar se për periudhën 01 maj 2022 - 21 nëntor 2022, inflacioni ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh që paga bazë e paditësve ka qenë 459 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për 6 muaj është 319.46 euro ( $459 \times 11.6\% = 53.24 \times 6 = 319.46$  euro) si dhe periudha 21 ditë të muajit nëntor është 37.25 euro, ( $53,244 \div 30 = 1.77 \times 21 \text{ ditë} = 37.25$ ) =  $319.46 + 37.25 = 356.71$  euro për secilin prej paditësve. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë 312 euro për përpilimin e padisë, 41 euro për taksën gjyqësore dhe për çdo seancë shumën prej 405 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësja ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtës së saj pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar

procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga kontrata e punës me numër protokollit 225/21, e datës 21.02.1991, për paditësen P.Sh. nga kontrata e punës me numër protokollit 586/17, e datës 21.09.2017, për paditësen M.V. nga kontrata e punës me numër protokollit 652/15, e datës 02.12.2015, për paditësin A.L. nga kontrata e punës me numër protokollit 503, e datës 11.09.2020, për paditësin S.A. nga kontrata e punës me numër të protokollit 643/15, e datës 02.12.2015, për paditësin R.V. e lëshuar nga Komuna e Prizrenit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, në Gjimnazin "Remzi Ademaj" në Prizren, si mësimdhënës. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësve e që është shuma prej 459.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se "Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja

*apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.*

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve u takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01 maj 2022 – 21 Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 356.71 euro ( $459.00 \times 11.6\% = 53.24 \times 6 \text{ muaj} = 319.46$  euro) si dhe periudha 21 ditë të muajit nëntor është 37.25 euro, ( $53.24 \div 30 = 1.77 \times 21 = 37.25$  euro) =  $319.46 + 37.25 = 356.71$  euro.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, andaj ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (11.12.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë

faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe për taksën gjyqësore në shumën prej 31.00 euro, ndërsa gjykata e refuzoi diferencën e kërkuar prej 10.00 euro, pasi që nga urdhërpagesa shihet se i autorizuari i paditësve e ka paguar taksën gjyqësore në shumën prej 30.00 euro dhe jo në shumën prej 40.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 dhe 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.4654/2023, me datë 07.10.2024**

**G j y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
**Gëzim Shehu**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.